



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 24 prill 2012

Nr. ref.: RK223/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI-08/11

Parashtrues të kërkesës

Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rrahman Kabashi dhe Liman Gashi

kundër

Autoritetit të panjohur publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues të kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Malush Sopa, në cilësinë e kryetarit të Sindikatës së Pavarur të NBI “Suhareka” në Suharekë, Sedat Kuqi, ish-drejtor i NBI “Suhareka” në Suharekë, Fazli Morina, drejtor i Vreshtarisë, Rrahman Kabashi, drejtor i Verëtarisë në fshatin Mohlan, dhe Liman Gashi, drejtor komercial në Suharekë.
2. Parashtruesit e kërkesës parashtruan një sërë dokumentesh në Gjykatën Kushtetuese, të cilat i quajtën “Vërejtje para padisë”. Ata dorëzuan autorizimin për t’i përfaqësuar tetëdhjetë (80) ish punëtorët e “Suharekës”.
3. “Gjykata Kushtetuese e Kosovës - Kryetari” është ndër 12 (dymbëdhjetë) autoritetet publike të adresuara, të cilëve ua dërguan “Vërejtjen para padisë”.

Vendimi i kontestuar

4. Lënda e atij memorandumit është: “Vërejtje para padisë kundër zvarritësve të lëndës SCC-09-0213, të 31.01.2011, sipas padisë së 16 nëntorit 2009 dhe ankesës Nr. 474, të 15.02.2011” dhe ka të bëjë me blerjen e NBI “Suhareka” sh.p.k., në Suharekë.
5. Parashtruesit pohojnë që, *“Më 19 nëntor 2009, Sindikata e Pavarur e NBI “Suhareka” në Suharekë, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar me autorizimin e 23 tetorit 2009, i ka paditur: 1) Agjencinë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë; 2) QMI – Qendrën e Mobileve Italiane, Sh.p.k., me seli në Suhodoll të komunës së Lipjanit; 3) Gruppo Vinicolo Fantinel Spa nga Italia, kjo padi mund të gjendet në lëndën SCC-09-0213”.*
6. Parashtruesit më tej theksojnë që, *“Më 31 janar 2011, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (...) lëshoi (...) Vendim me të cilin e hedh poshtë padinë tonë si të papranueshme dhe pa asnjë bazë, edhe pse në çështjen ligjore SCC-09-0213 të gjitha faktet dhe provat u ishin bashkëngjitur dokumenteve që u nënshkruan më 28 nëntor 2006 në Treviso të Italisë për mashtrim dhe konspiracion kundër kolektivit tonë”.*
7. Së fundi, parashtruesit theksojnë që, *“Më 15 shkurt 2011, Sindikata e Pavarur e NBI “Suhareka” në Suharekë e ka parashtruar, brenda afatit ligjor, ankesën Nr. 474 në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë dhe i ka njoftuar të gjitha misionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë për (...) Vendimin SCC-09-0213 të 31 janarit 2011 kundër kolektivit tonë në kundërshtim me*

nenin 346 të KPK-së dhe nenit 102, paragrafëve 2, 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (...)”.

Çështja e lëndës

8. Parashtruesit e dorëzuan “Vërejtjen para padisë” në Gjykatën Kushtetuese, në mesin e shumë dispozitave të tjera ligjore, “në pajtim me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për mjete juridike], 44 [Liria e Asociimit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 84.6 [Kompetencat e Presidentit], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve], 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Baza juridike

9. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

10. Më 26 janar 2011, parashtruesit e dorëzuan “Vërejtjen para padisë” të përmendur më sipër.
11. Më 14 shkurt 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
12. Më 16 shkurt 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë dhe gjithashtu ua dërguan dokumentet e sipërpërmendura shtesë 12 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.
13. Më 1 qershor 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë dhe përsëri ua dërguan dokumentet e sipërpërmendura 12 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

14. Më 26 korrik 2011, Ndërmarrja Shërbyese “Ekspertimi” dorëzoi në Gjykatë një dokument të quajtur “Mendimi financiar” në lidhje me kërkesën e parashtruesit. Të njëjtën datë, ndërmarrja e sipërpërmendur ua dërgoi dokumentin e sipërpërmendur 11 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.
15. Më 28 korrik 2011, Ndërmarrja Shërbyese “Ekspertimi” dorëzoi një letër në Gjykatë, me anë të së cilës i sqaronte disa gabime teknike në dokumentin e quajtur “Mendimi financiar”, të cilin e dorëzoi në Gjykatë më 26 korrik 2011.
16. Më 2 gusht 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë, dhe ua dërguan dokumentet e sipërpërmendura 14 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.
17. Më 2 gusht 2011, Ndërmarrja Shërbyese “Ekspertimi” iu përgjigj pyetjeve të Gjykatës, të parashtruara më 26 korrik 2011, lidhur me cilësinë e saj për ta dorëzuar në Gjykatë “Mendimin financiar” lidhur me kërkesën e parashtruesit.
18. Më 12 gusht 2011, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e “Vërejtjes para padisë” (kërkesës). Të njëjtën datë, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, QMI – Qendra e Mobileve Italiane dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, u njoftuan për regjistrimin e kërkesës; ata nuk kanë ofruar asnjë përgjigje deri më sot.
19. Më 17 gusht 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë. Dokumentet e sipërpërmendura ua dërguan 16 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.
20. Më 5 shtator 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë dhe, përsëri, të njëjtat dokumente ua dërguan 18 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.
21. Më 14 shtator 2011, nga parashtruesit u kërkua t’i sqaronin dhe plotësonin disa aspekte të kërkesës që kishin të bënin kryesisht me: të dhënat personale të përfaqësuesit; të dhënat faktike për aktin/aktet e autoriteteve publike për të cilin/cilat ankohen; emrin e saktë të gjykatës ose të autoritetit publik për të cilin pohojnë se me veprimet ose lëshimet e veta ua ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë; të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë të cilat pohojnë se u janë shkelur; ankesën sipas Kushtetutës, që tregon cili nen i/cilat nene të Kushtetutës gjoja është/janë shkelur nga autoriteti publik dhe që tregon pse akti i këtij autoriteti/aktet e këtyre autoriteteve

përbën/përbëjnë shkelje të Kushtetutës; vendimin përfundimtar të gjykatës apo të autoritetit, nëse ka; dhe çka dëshirojnë të arrijnë përmes parashtrimit të kësaj kërkesë në Gjykatë.

22. Më 20 shtator 2011, parashtruesit i dorëzuan pak a shumë të njëjtat dokumente, të cilat iu dërguan 19 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.
23. Më 4 tetor 2011, parashtruesit iu përgjigjën pyetjeve të Gjykatës duke dorëzuar të njëjtin grup të dokumenteve, por tani e dorëzuan edhe marrëveshjen e 27 gushtit 2007, të lidhur ndërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), në njërën anë, dhe QMI-së – Qendrës së Mobileve Italiane dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, në anën tjetër.
24. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe Gjykatës i rekomandoi papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

25. Më 19 qershor 2006, Gjykata Komunale në Suharekë lëshoi *Aktgjykim në bazë të pohimit C. nr. 217/05*, duke u bazuar në padinë e parashtruesve kundër të paditurës NBI – NSH “Suhareka” në Suharekë, të cilën e përfaqësonte me autorizim Nazim Elshani, avokat, lidhur me kompensimin e të ardhurave personale të punëtorëve për periudhën prej vitit 1991-1998, i cili përmbante me sa vijon:

“APROVOHET padia dhe kërkespadija e punëtorëve të NBI "Suhareka" në Suharekë, sipas regjistrimit të dt. 11.11.2003. j cili gjindet në shkresat e landës prej 1 duke filluar nga punëtori Sadik Ahmeti e deri në 186 deri te punëtori Muhamet Elshani ndaj të paditurës NBI "Suhareka" në Suharekë.

OBLIGOHET e paditura NBI "Suhareka" në Suharekë që të gjithë punëtorve sipas regjistrimit te dt. 11.11.2003 i cili gjindet ne shkresat e landes nga nr. rendor 1 duke filluar nga punetori Sadik Ahmeti e deri te numri rendor 186 te punetori Muhamet Etshani te ia paguaj te ardhurat sipas regjistrimit te punetorve si dhe Vendimeve te veqanta te Keshillit te punetorve secilit veq e veq te parapara ne regjisterin . dhe ate shuma e pergjithshme ae te gjithe punetorve sipas regjistrimit e dt. 11.11.2003 e nenshkruar nga ana e komisionit eshte 750.087,00 Euro. ne shume te pergjithshme pa kamat.

Ky aktgjykim mund te ekzekutohet ne momentin e privatizimit te ndermarjes NBI "Suhareka" ne Suhareke., per realizimin e kesaje te drejte".

26. Në arsyetimin e të njëjtit *Aktgjykim në bazë të pohimit*, Gjykata Komunale në Suharekë tha me sa vijon:

"Gjykata duke u bazuar ne pohimet e pef. Te punetorve dhe perf. te NBI "Suhareka" ne Suhareke se per kete qeshtje eshte e njoftuar edhe agjensioni i Mirebesiit vendosi qe kerkespadin te aprovoi ne teresi dhe te bjen Aktgjykim ne baze te pohimit 331 te LPC".

27. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) në vitin 2006-2007, gjatë valës së 19 të privatizimit me spin-off special, i shpalli QMI-në – Qendrën e Mobileve Italiane, me seli në Lipjan, dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, me seli në Spilimbergo (Pordenone) të Italisë, fitues të përkohshëm të tenderit të privatizimit.

28. Më 16 nëntor 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) kundër të paditurve: Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, QMI– Qendra e Mobileve Italiane, me seli në Lipjan, dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, me seli në Spilimbergo (Pordenone) të Italisë, përmes të cilës kërkuan anulimin e privatizimit të NSH "Suhareka" në Suharekë, duke pohuar se fituesi i përkohshëm konspiroi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) si shitës.

29. Më 21 janar 2010 dhe 23 shkurt 2010, DHPGJS lëshoi një urdhër me të cilin e udhëzonte parashtruesin lidhur me nevojën për përkthime, dhe që Sindikata duhet të jetë e përfaqësuar nga një avokat në DHPGJS.

30. Më 19 mars 2010, parashtruesi e dorëzoi përkthimin e padisë në DHPGJS. Parashtruesi kërkoj anulimin e privatizimit të NSH "Suhareka" në Suharekë, duke pohuar se fituesi i përkohshëm i tenderit të privatizimit konspiroi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit si shitës. Më 30 korrik 2010, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në DHPGJS, duke theksuar lidhjen e mundshme kriminale të rastit.

31. Më 4 gusht 2010, DHPGJS përsëri lëshoi një urdhër me të cilin e udhëzonte parashtruesin që ta dorëzonte autorizimin dhe një instrument, ose instrumente, për themelimin e personit juridik (Sindikates) në pajtim me nenet 24.1 dhe 25.4 të UA të

UNMIK-ut 2008/6. Të njëjtën ditë, DHPGJS iu drejtua Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe kërkoi të mësonte nëse ka pasur hetime penale lidhur me pretendimet e parashtruesit. DHPGJS iu drejtua edhe Gjykatës Komunale në Suharekë për ta marrë një kopje të lëndës C. nr. 233/2009, të përmendur në padi.

32. Më 12 gusht 2010, Gjykata Komunale në Suharekë e dorëzoi dosjen e kërkuar, në të cilën deklaroi se nuk ishte kompetente dhe e informoi parashtruesin që DHPGJS ka juridiksion për këtë rast.
33. Më 25 gusht 2010, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në DHPGJS me të cilat e plotësonte padinë e vet. Më 23 shtator 2010, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në DHPGJS. Parashtruesi nuk i bashkëngjiti dokumentet e kërkuara nga DHPGJS-ja në asnjërën parashtrësë.
34. Më 25 gusht 2010, gjithashtu, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ia konfirmoi DHPGJS-së se janë duke e intervistuar parashtruesin por nuk mund ta konfirmonte ekzistencën e një hetimi në vazhdim e sipër.
35. Më 24 shtator 2010, DHPGJS-ja edhe një herë e urdhëroi parashtruesin që ta dorëzonte autorizimin dhe një instrument, ose instrumente, për themelimin e personit juridik (Sindikates) në pajtim me nenin 25.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6. DHPGJS ofroi sqarim të detajuar në urdhrin me të cilën ia tërhoqte vërejtjen parashtruesit se dështimi për të vepruar në përputhje me këtë urdhër do të rezultojë në refuzim të padisë mbi bazën e papranueshmërisë.
36. Në kuadër të ankesës së vet të 11 tetorit 2010 kundër këtij urdhri, të plotësuar më 23 nëntor 2010, parashtruesi kërkoi *“që të përjashtohet nga vendimi në këtë lëndë Gjyqtarja e EULEX-it Esma Erterzi për shkak të sjelljes së saj të njëanshme ku ajo dha aktvendimin e paligjshëm, antikushtetues dhe diskriminues dhe duke mashtruar kolektivin tonë prej 237 punëtorësh sipas dispozitave ligjore”*, duke iu referuar në këtë mënyrë argumenteve të veta në ankesë se duhet t'i lejohet që të vetë-përfaqësohet dhe se nuk do *“të pranojë asnjë avokat nga askush”*.
37. Më 23 nëntor 2010, “Kërkesa për përjashtim” e parashtruesit u refuzua si e pabazuar me vendimin e Kryetarit të DHPGJS-së, me numrin AGJ-2010-132. Megjithatë, procedura e ankesës kundër urdhrit të Gjyqtarës raportuese të DHPGJS-së, e 24 shtatorit 2010, është në procedurë e sipër. Megjithatë, Trupi Gjykses konsideron se ankesa kundër urdhrit të

gjyqtares përgjegjëse nuk e pengon Trupin Gjykses që të marrë vendim për pranueshmëri të padisë.

38. Më 31 janar 2011, DHPGJS (Vendimi SCC-0213) hodhi poshtë si të papranueshme padinë e parashtruesit për anulimin e privatizimit të NSH "Suhareka". Në vendimin në fjalë, DHPGJS ia ofroi parashtruesit këtë këshillë ligjore:

"Pasi që Dhoma e Posaçme nuk ka lëshuar një Aktvendim për meritat e padisë, Paditësi mund të ushtrojë një padi të kompletuar apo të korrigjuar në bazë të Rregulloreve të UNMIK-ut dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6."

"Në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim tek Kolegji i Ankesave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimi të këtij aktvendimi."

Vlerësimi i pranueshmërisë

39. E ashtuquajtura "Vërejtje para padisë", që përfshinë, pak a shumë, të njëjtat dokumente që u parashtruan në data të ndryshme dhe që iu dërguan autoriteteve të ndryshme, nuk figuron si kërkesë e formatit ligjor e dizajnuar për t'u ankuar kundër shkeljes së të drejtave të mbrojtura kushtetuese nga autoritetet publike, që është çështja kryesore e punës së Gjykatës Kushtetuese.
40. Përkundrazi, parashtruesit njëkohësisht dhe paralelisht dhanë "Vërejtjen para padisë", duke ua dërguar të njëjtën informatë dymbëdhjetë/nëntëmbëdhjetë institucioneve dhe autoriteteve të ndryshme.
41. Prandaj, duke pasur parasysh natyrën ligjore dhe fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese, "Vërejtja para padisë" nuk do të binte nën shqyrtimin paraprak të Gjykatës dhe fare nuk do të duhej të ishte regjistruar, megjithatë, Gjykata do ta shqyrtojë për hir të qëllimeve pedagogjike.
42. Neni 113 (1 dhe 7) i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme të kritereve juridike për pranueshmëri. Ai thotë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7 Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

43. Ato kritere për pranueshmëri shtjellohen më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës, të cilat specifikojnë ndër të tjera: respektimin e afatit të paraparë; arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës, me një përmbledhje të shkurtër të fakteve dhe sqarim të përpiktë të të drejtave që janë shkelur; aktin konkret të autoritetit publik që kontestohet dhe mbrojtjen juridike që kërkohet; dhe bashkëngjitjen e informacioneve dhe dokumentacionit të nevojshëm mbështetës.
44. Parashtruesit nuk janë duke vepruar si individë, por si përfaqësues të personave juridikë. Neni 21.4 i Kushtetutës thotë që *“të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*. Prandaj, parashtruesit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kushtetuese (*Shih Aktvendimin në rastin Nr. KI. 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, paragrafi 14*).
45. Megjithatë, kjo do të thotë që edhe parashtruesit janë të obliguar t'i shterojnë të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj, siç përcaktohet në nenin 113.7 për individë.
46. Qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është që t'u lejojë autoriteteve publike, përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për t'i parandaluar ose korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike është i ndërlidhur në mënyrë operative me karakterin subsidiar të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese (*Shih Selmouni kundër Francës [DHM], paragrafi 74; Kudla kundër Polonisë [DHM], paragrafi 152; Andrášik dhe të tjerët kundër Sllovakisë (vendim)*).
47. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesit t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta, qoftë administrative apo gjyqësore, për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore. Prandaj, parashtruesit rrezikojnë që rastet e tyre t'u shpallen të papranueshme nga Gjykata Kushtetuese nëse dështojnë t'i shfrytëzojnë procedurat e

rregullta ose nëse dështojnë ta raportojnë shkeljen e Kushtetutës në procedura të rregullta. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për ta kundërshtuar shkeljen dhe për t'u ankuar (*Shih Aktvendimin në rastin Nr. KI. 07/09, Demë KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl.nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18*).

48. Në rastin në fjalë, parashtruesit vepruan njëkohësisht dhe paralelisht, gjë që është tërësisht kundër natyrës pasuese dhe hap pas hapi të rregullit të shterimit të mjeteve juridike. Prandaj, ata treguan se nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me sistemin e rregullt juridik.
49. Prandaj, duke pasur parasysh tërë këtë që u tha më lart, Gjykata duhet të konkludojë që e ashtuquajtura kërkesë qartazi duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.
50. Në anën tjetër, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

51. Parashtruesit gjithashtu dështuan të saktësonin se cilat të drejta dhe liri u janë shkelur dhe cilin akt të autoritetit publik e kontestojnë. Ata nuk tregojnë asnjë formë të shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
52. Përveç kësaj, parashtruesit as nuk e kanë mbështetur me prova rastin në të cilin konsiderojnë se janë viktimë të shkeljes së Kushtetutës (*Shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DHM], paragrafi 179*), as nuk kanë bashkëngjitur informacione dhe dokumentacion të nevojshëm mbështetës, as që kanë treguar mbrojtjen juridike që kanë kërkuar.
53. Në të vërtetë, procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë kundërthënëse në natyrë. Prandaj, u takon palëve që t'i mbështesin argumentet e tyre faktike (duke ia dorëzuar Gjykatës provat e nevojshme faktike) dhe argumentet e tyre ligjore (të cilat sqarojnë si dhe pse, sipas mendimit të tyre, dispozitat kushtetuese në të cilat janë mbështetur janë apo nuk janë shkelur). Gjykata është përgjegjëse për vërtetimin e fakteve; është detyrë e palëve të sigurojnë ndihmë aktive duke ia dorëzuar të gjitha informatat e duhura mbështetëse dhe dokumentacionin përkatës.

54. Nga sa u tha më lart, nuk është detyrë e Gjykatës të supozojë cili është qëllimi i parashtruesve apo ta ndërtojë rastin në emër të tyre. Përkundrazi, sipas nenit 113.1 të Kushtetutës, është detyrë e parashtruesve të parashtrojnë çështjen në Gjykatë “në mënyrë ligjore” dhe në pajtim me të gjitha kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.
55. Shkurtimisht, Gjykata mendon që “Vërejtja para padisë”, e përmendur më lartë, nuk e arrin pragun minimal për t’u konsideruar “mënyrë ligjore” e parashtrimit të çështjes në këtë Gjykatë.
56. Mënyra në të cilën “Vërejtja para padisë” është parashtruar në Gjykatë mund të shihet, në qasje të rreptë, si abuzim i të drejtës për t’u ankuar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktoi që *“çdo sjellje e parashtruesit e cila është qartazi në kundërshtim me qëllimin e të drejtës së kërkesës individuale, siç parashihet në Konventë, dhe që e pengon funksionimin e mirëfilltë të Gjykatës apo zhvillimin e mirëfilltë të procedurës para saj përbën abuzim të drejtës së kërkesës” (Shih Mirolubovs dhe të tjerët kundër Lituaniës*, paragrafët 62 dhe 65).*
57. Gjykata Kushtetuese është e detyruar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton që *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
58. Megjithatë, Gjykata mendon që në këtë fazë të zhvillimit të praktikës gjyqësore kushtetuese në Kosovë, nuk këshillohet të miratohet një qasje e rreptë e tillë. Megjithatë, është me rëndësi që parashtruesit ta dinë këtë, pasi duket që e kanë keqkuptuar rolin e Gjykatës Kushtetuese dhe natyrën e kornizës së punës së drejtësisë kushtetuese, siç përcaktohet në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores, më 23 nëntor 2011, me SHUMICË VOTASH

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani